

VENDIM
Nr. 474, datë 8.6.2017

**PËR NJË RISHPËRNDARJE TË FONDEVE TË BUXHETIT TË VITIT 2017,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe të neneve 44, shkronja “a”, dhe 47, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” 04220, shtohet fondi prej 148 000 000 (njëqind e dyzet e tetë milionë) lekësh, shpenzime korrente, për vaksinimin e kafshëve të llojit gjedh kundër sëmundjes së Dermatozës Nodulare (*Lumpy Skin Disease*);

b) Në programin buxhetor “Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun”, pakësohet fondi prej 148 000 000 (njëqind e dyzet e tetë milionë) lekësh, shpenzime korrente, nga skema mbështetëse për bujqësinë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama